

## EMISARËT JUGOSLLAVË – TUTORË TË UDHËHEQËSVE TË PKS-H-SË

Daut BISLIMI

Instituti Albanologjik  
Prishtinë

KUD: 949.65  
Punim studimor

Marrë për botim, më 30.0X.2002

*Përmbajtja e shkurtër:* Ky punim ka mbështetjen në dokumentet themelore të PKS-H-së, më saktësisht në dokumentet e Plenumit II të KQ të PKS-H-së, mbajtur në Berat më 23 nëntor 1944, dhe ka për qëllim ndriçimin me saktësi shkencore të vijës politike të PKS-H-së ndaj emisarëve jugosllavë, të vendosur pranë KQ të PKS-H-së gjatë Luftës Antifashiste 1941-1944.

Deri në ditët tona historiografia shqiptare nuk ka bërë studime të thelluara analitike dhe të veçanta lidhur me rolin, angazhimin dhe veprimtarinë strategjike të emisarëve jugosllavë Miladin Popoviq, Dushan Mugosha dhe të tjerëve, më pak të rëndësishëm, pranë PKS-H-së, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kështu që kjo pjesë e historisë së Luftës Antifashiste, në rastin tonë, e veprimtarisë së emisarëve jugosllavë “në ndihmë PKS-H-së – Luftës “Çlirimtare”, nuk është ngritur në nivelin e interesimit shkencor, me qëllim të ndriçimit të së vërtetës historike me shumë interes për historinë shqiptare të Luftës së Dytë Botërore, sepse ngjarjet që pasuan gjatë tërë periudhës së luftimeve dhe menjëherë pas saj, e shpjeguan faktin se këta emisarë të deleguar nga qendra e kominternit të Beogradit, kishin ndikim të posaçëm në PKS-H-në si dhe në rrjedhat e përgjithshme të Luftës Antifashiste në Shqipëri, me të vetmin qëllim që në terrin e luftës, duke bashkëpunuar ngushtë me PKS-H-në (simpatizantët e kominternit), ta shkatërrojnë trurin dhe ndërgjegjen shqiptare, në mënyrë që Shqipëria Etnike të mos jetë më kurrë objekt shqyrtimi në analet e historisë.

Çështja e emisarëve jugosllavë, roli dhe veprimtaria e tyre pranë PKS-H-së, duhet të ngritet në nivelin e studimeve historike kombëtare për

t'u dhënë përgjigje në shumë pyetje që shtron e tashmja dhe e nesërmja historike shqiptare. Shumë studiues të fushës historike që pretendojnë të jenë njohës të mirë të problemit shqiptar gjatë Luftës Antifashiste Çlirimtare dhe menjëherë pas, duke mos qenë në gjendje të njohin dokumentacionin arkivor dhe duke mos konsultuar literaturën shkencore me peshë historike për këtë problem, i shërbejnë pseudoshkencës dhe e dëmtojnë rëndë historinë, përpjekjet dhe kontributin e popullit shqiptar në këtë luftë për çlirim kombëtar dhe vetëvendosje.

Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, mbështetur në studimin e faktografisë arkivore dhe studimin e subjektit njeri-pjesëmarrës aktiv në këto ngjarje me peshë kombëtare, ka mendime që dallojnë nga studimet e mëhershme të këtij rrafshi, që janë të argumentuara mirë dhe të qëndrueshme kur është fjala për rolin e emisarëve jugosllavë Miladin Popoviq dhe Dushan Mugosha dhe rreth aktivitetit të tyre në Lëvizjen Antifashiste dhe në aktivitetin e PKSH-së.<sup>1</sup>

Disa historianë, të veshur me petkun e ideologjisë së “luftës së klasave”, edhe sot nuk u japin atyre më tepër se rolin e këshilltarit, e ndihmësit (madje për Miladin Popoviqin edhe të ndihmësit dashamirës). Disa historianë të tjerë, ata të cilët vrapuan pas titujve të lartë shkencorë, mendojnë se fenomenet negative, gabimet e vijës politike të PKSH-së ishin rezultat i papjekurisë politike të udhëheqjes së PKSH-së dhe Miladin Popoviqit. Këto pikëvështrime marksiste, tashmë janë të njohura mirë, në filozofinë e zhvillimit të shoqërisë shqiptare, nuk thelloheshin në

<sup>1</sup> Prof. Ndreçi Plasari – Dr. Luan Malltezi, Politika antikombëtare e Enver Hoxhës. Dokumente. Plenumi II i KQ të PKSH-së, Berat 23-27 nëntor 1944. Tiranë 1996; Dr. Daut Bislimi, Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë 1997; Muharrem Dezhgiu, Shqipëria në luftë (1939-1944). Studime dhe refleksione, Tiranë, 2001; Prof. asoc. dr. Beqir Meta – Prof. asoc. dr. Muharrem Dezhgiu, *Probleme të Luftës Çlirimtare Antifashiste në dritën e Plenumit II të KQ të PKSH-së*, 23 nëntor 1944. (Punim në dorëshkrim). Tiranë 2001, f. 75; AQSH, Fondi 40. *Rezolucioni i Konferencës së Pezës, 16 shtator 1942*; AQSH/AP, Fondi 14. *Trakt i PKSH drejtuar popullit kosovar*, dhjetor 1943; Fehmi Agani, *Partitë dhe grupet kryesore politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore* (punim i tez. dok. në dorëshkrim); Ndreçi Plasari, *Çështja kombëtare në programin e PKSH dhe të FNÇ në periudhën e Luftës së Dytë Botërore*, “Studime Historike”, 1-4 1993, 135-140; *Raport i Koço Tashkos dërguar Internacionalës Komuniste*, (vjeshhtë 1942), “Studime Historike”, 1-4 1993, 205-218; Muharrem Dezhgiu, *Ndërtharja e luftës për çlirim kombëtar me elemente të luftës civile në vitet 1943-1944*, “Studime historike”, 1-4 1993, 143-149; Agim Zogaj, *“Ndërhyrja e PKJ-së në veprimtarinë e PKSH-së dhe Plenumi II i KQ të PKSH-së”*. Punim i magistraturës, mbrojtur në Fakultetin Filozofik të Prishtinës më 1998.

pasojat dhe në plagët e kësaj “papjekurie” që ende kullojnë dhembje. Këta historianë edhe sot nuk duan të kuptojnë se PKSH-ja për një arsye apo për një tjetër, ideologjike, të mungesës së guximit, të servilizmit politik apo ideologjik ndaj Lëvizjes Komuniste Ndërkombëtare, përfshirë edhe raportet ndaj PKJ-së (përmes emisarëve jugosllavë), nuk e kanë ngritur çështjen e luftës për çlirimin nacional të popullit shqiptar në Kosovë në ato përmasa që do të duhej ta ngriste shteti shqiptar për zgjidhjen e problemit gjithëkombëtar në këtë luftë. Kjo do të ishte gjysma e së keqes, po që se sot, një takëm historianësh shqiptarë të mos ishin gati që të shkelin etikën e tyre shkencore për përkatësi ideologjike. Në fakt “rrënjët” e këtij servilizmi duhet kërkuar më thellë. Nuk janë interesat e të vërtetës historike që i shtyjnë këto historianë të përbuzin nacionalizmin shqiptarë. Janë interesat e pseudoshkencës të dijetarëve servilë, të nënshtruar nga ideologjia e “luftës së klasave” dhe që nuk e kanë guximin e shkenctarit progresiv të qëndrojnë para të vërtetës historike se PKSH-ja nuk luftoi për ta mbrojtur Shqipërinë Etnike, por e luftoi këtë krijesë për ta konsoliduar pushtetin e vet dhe se në këtë luftë pushteti personal u bë preokupim kryesor i angazhimit luftarak dhe diplomatik.

Në fillim është e nevojshme të sqarojmë se ndihma organizative e përfaqësuesve të një partie të vjetër për një parti të re është normale dhe në interes të atyre forcave politike që e marrin këtë ndihmë. Në këtë kontekst, në qoftë se kjo forcë politike ka një program progresiv për vendin dhe interesat kombëtare, atëherë kjo ndihmë do të jetë e dobishme për të gjithë shoqërinë. Mirëpo në këtë rast duhen sqaruar dy probleme:

a). Cilët janë kufijtë në kuadër të të cilëve do të veprojnë emisarët e një partie të huaj dhe ky është një problem tepër parimor e me pasoja të rëndësishme për fatet e kombit, dhe b). Duhet të ketë një kriter, ose duhet kërkuar disa prova që partia politike e një vendi të huaj nuk ka interesa të dyshimta ndaj vendit që e merr këtë ndihmë. Respektimi i këtyre parimeve vërehet sot në bashkëpunimin midis partive politike të vendeve të Evropës sipas pozicioneve të tyre në spektrin politik.

Si mund të gjykohet ndihma që PKJ-së i dha PKSH-së gjatë luftës dhe pas saj?

Historia e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të fundit të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX, mund të konsiderohet tepër dramatike. Serbia, e cila arriti që në këtë periudhë të okupojë dhe të fusë nën sundimin e saj gjysmën e trojeve të pastra etnike shqiptare,

vazhdonte të ushtronte ndaj popullsisë shqiptare një dhunë sistematike dhe po zhvillonte një proces të egër shkombëtarizimi.

Njëkohësisht nuk kishin reshtur as përpjekjet e saj për ta dezintegruar shtetin shqiptar dhe për t'i shkëputur atij territore të tjera. Pra, për shqiptarët nuk kishte më asnjë dyshim se politika jugosllave përbënte një kërcënim për Shqipërinë.<sup>2</sup>

Socialdemokracia serbe, pasardhëse e së cilës ishte PKJ-ja, kishte denoncuar në disa raste gjenocidin shovinist serb në Kosovë dhe ky fakt mund të përbënte një bazë afrimi dhe bashkëpunimi, por ajo nuk ishte shprehur asnjëherë për të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe nuk kishte denoncuar aneksimin e saj nga Serbia. Prandaj me PKJ-në duhej kërkuar bashkëpunimi si një forcë antifashiste, por ky duhej të ishte shumë i përcaktuar, shumë i kujdesshëm dhe i qartë. Nga ana tjetër PKJ-ja ishte e domosdoshme të jepte prova, qysh gjatë luftës, se ajo do ta respektonte të drejtën e popullit të Kosovës për vetëvendosje. A i patën parasysh udhëheqësit e PKS-së këto rrethana? Përgjigjja është kategorike: – Jo !. Por, le t'iu referohemi dokumenteve.<sup>3</sup>

Në Plenumin e Beratit, nëntor 1944, nga të gjithë pa përjashtim, u pranua roli dominues i emisarëve jugosllavë ndaj udhëheqjes së PKS-së. Njëkohësisht në këtë plenum shihet një dritë e vogël në fund të shkallëve të përgjegjësisë së krerëve udhëheqës të PKS-së, për dëmet që ia bënë dhe që i kushtuan shumë Luftës Antifashiste Çlirimtare.

Këtu u tha një e vërtetë e madhe dhe faktografi e qëndrueshme se emisarët jugosllavë të PKJ-së, fituan këtë rol **së pari** në saje të përçarjes së thellë që ekzistonte midis grupeve komuniste para themelimit të PKS-së. Kjo përçarje mbeti edhe pas krijimit të partisë, kështu që emisarët jugosllavë u bënë arbitra në mes komunistëve shqiptarë e njëherazi edhe zotë të tyre.

**Së dyti**, ata përfituan nga papjekuria politike, nga mungesa e horizontit politik, e eksperiencës politike të komunistëve shqiptarë. Enver Hoxha në raportin e tij në Berat pohonte: “Gati të gjithë ne shokët e Komitetit Qendror provizor ishim pa eksperiencë partie, pa eksperiencë organizative dhe pa pikëpamje politike të gjera”.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Dr. asoc. Beqir Meta - Dr. asoc. Muharrem Dezhgju, *Probleme të Luftës Çlirimtare Antifashiste në dritën e Plenumit II të K.Q. të PKS, 23 nëntor 1944. Materialet*. (Punimi në dorëshkrim), Tiranë, 2001.

<sup>3</sup> Po aty, 48.

<sup>4</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1942, D.5.

**Së treti**, në veprën e tyre për dominimin e udhëheqjes së PKSH-së ata përfituan nga tendencat karrieriste, cilësitë e dobëta morale, nga servilizmi dhe aventurizmi i elementëve të tillë, si: Enver Hoxha, Liri Gega, Koçi Xoxe, Naku Spiru etj.

**Së katërti**, ata kishin prapa tyre udhëzimet dhe direktivat e udhëheqjes së PKJ-së. Ndikimi i PKJ-së mbi PKSH-në u siguroi në radhë të parë nëpërmjet direktivave. Qoftë direktivat e Kominternit, qoftë udhëzimet e tjera më të detajuara për vijën politike të PKSH-së vinin nëpërmjet Beogradit.<sup>5</sup>

Pastaj, PKJ-ja dhe emisarët e saj përcaktuan gjithë vijën politike të PKSH-së dhe taktikat e saj. Në Plenumin e Beratit, por edhe nga dokumente të tjera qartazi del se të gjitha momentet kryesore politike i ka drejtuar PKJ-ja.

PKJ-ja nëpërmjet Komitetit Krahinor të Kosovës në mbledhjen e Vitomiricës të 11 tetorit 1941, përcaktoi delegatët që do të merrnin pjesë në mbledhjen themeluese të PKSH-së dhe programin që do ta shtronin aty. Ky program shërbeu si platformë për hartimin e rezolucionit të grupeve.

Në Konferencën e Pezës referatin për PKSH-në e përgatiti Miladin Popoviqi. Kjo gjë vërtetohet nga thëniet e Enver Hoxhës.

Denoncimi i Mukjes u bë nën ndikimin e përfaqësuesve të PKJ-së, përkatësisht të Miladin Popoviqit.<sup>6</sup>

Konferencën e Parë të Vendit në Shqipëri e përgatitën Miladin Popoviqi dhe Blazha Jovanoviqi. Enver Hoxha pohonte në Plenum: “Si për të gjitha evenimentet e Partisë, deri në fund në krye ishte Aliu”. Por kryesori i Konferencës ishte Blazhoja. Blazhoja ka ndihmuar më shumë në përgatitjen e referateve, sidomos në referatin ushtarak. Kur erdhi Blazhoja me direktivat e Kominternit, sikurse na erdhi perëndia. Në Kongresin e Përmetit Rezolucioni dhe Vendimet erdhën të gatshme nga Jugosllavia. Këtë e pohoi Plenumi dhe KQ-ja nuk e kuptonte se si do të zbatoheshin ato etj.

<sup>3</sup> Pas sulmeve të Fuqive të Boshtit në Bashkimin Sovjetik, Kominterni dërgoi direktivë që të fillohet me aksione të diversioneve, terrorizmit dhe të atentateve kundër forcave kundërrevolucionare dhe fashizmit. **“Merreni në konsiderim, që në këtë fazë fjala është kundër zgjedhës së fashizmit, e jo mbi revolucionin socialist”**; (V.I. Lenin, *Isabrana djela*, Zagreb 1950, vëll. 2, 303.

<sup>6</sup> Dr. Muharrem Dezhgiu – Dr. Beqir Meta, stu. i cit. 49.

Në diskutimin e tij në Plenum, Velimir Stojniqi vuri në dukje se ai kishte qenë iniciator i shndërrimit të Komitetit Antifashist në Qeveri të Përkohshme dhe se ai kishte sjellë nga Jugosllavia direktivat për organizimin e informacionit në ushtri, organizimin e shtetit të përgjithshëm për unifikimin e komandës dhe krijimin e reparteve të reja etj.<sup>7</sup>

Një problem që ka shkaktuar diskutime dhe paqartësi të historianët e paorientuar mirë dhe tek ata me orientime ideologjike, është çështja e autorësisë së themelimit të PKSH-së.

Burimet ekzistuese - dokumentet arkivore, studimi i subjektit njeri-pjesëmarrës aktiv në këto ngjarje me peshë për historinë shqiptare, sikurse edhe nga materialet e Plenumit të Beratit, qartazi del në pah se Partia Komuniste jugosllave ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë eveniment historik. Natyrisht, ishte dëshira e komunistëve shqiptarë për themelimin e një partie komuniste. Por ata nuk po e gjenin dot rrugën e bashkimit. Përfaqësuesit e PKJ-së menjëherë morën në dorë situatën dhe imponuan kultin e tyre. Ata shfrytëzuan papjekurinë politike dhe admirimin që kishte për ta një pjesë e udhëheqjes së PKSH-së si dhe autoritetin që ua jepte atyre PKJ-ja – si një parti e vjetër komuniste, e cila ishte e lidhur drejtpërdrejt me Kominternin.

Përveç dokumenteve që pasqyrojnë mbledhjen e Vitomiricës (tetor 1941), në të cilën u hodhën bazat për krijimin e PKSH-së (pra u bë puna përgatitore), këtë fakt e provon edhe letra e Koço Tashkos dërguar Kominternit në vjeshtë të vitit 1942.<sup>8</sup> Tashko pohon se dy të dërguarit e PKJ-së luajtën rol themelor për shkrirjen e grupeve dhe për themelimin e PKSH-së. Dërgimin e tyre në Shqipëri e kishte kërkuar vetë si pranë Komitetit Qendror të PKJ-së për Kosovën dhe Metohinë, kur kishte vajtur atje për të kërkuar ndërmjetësimin e PKJ-së për likuidimin e grupeve në Shqipëri në shtator 1941. Në këtë letër Koço Tashko i shkruante Kominternit: “Tërë përgjegjësia iu dorëzua këtyre dy shokëve (Për drejtimin e KQ të Partisë) vetëm duke u bazuar në rekomandimin e Komitetit Qarkor të PKJ-së për Kosovë e Metohi”.

**Të PKJ-ës dhe nga bindja ime “se sado të këqia të jenë rezultatet nuk do të kishin qenë më të këqia se sa po të vazhdonte lufta e grupevet ose sa po të isha unë në Komitetin Qendror bashkë**

<sup>7</sup>. AQSH, Fondi 14, viti 1944, D. 2/1. Diskutimi i V.Stojniqit në Plenumin e Beratit.

<sup>8</sup>. AQSH, Fondi 14, viti 1942, D.5.

**më kreret e tjerë të grupeve me të cilët kishim patur një luftë të egër personale**".<sup>9</sup>

Plenumi i Beratit e konfirmoi edhe njëherë rolin e emisarëve jugosllavë për themelimin e PKSH-së. Pandi Kristo theksonte se themelimi i PKSH-së “u arrit me ndihmën e PKJ-së që ne e shikonim te Miladini e Dushani. E shikonim atje, pse ne që kishim nga fryma e grupeve, këta shokë qenë ata që na shpëtuan nga kjo frymë”.<sup>10</sup>

Dy të dërguarit jugosllavë vepruan në bazë të një platforme të studiuar për të përçarë e nënshtruar udhëheqjen e PKSH-së. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në Plenumin e Beratit denoncuan krijimin e një klike në krye të PKSH-së (Miladin Popoviqi, Liri Gega e Enver Hoxha).

Njëra nga metodat e tyre ishte krijimi i pakënaqësive dhe i xhelozive në kuadrot kryesore të PKSH-së nëpërmjet trajtimit të tyre të diferencuar. Nako Spiro pohonte para Plenumit: “Politika e Dushanit dhe “Aliut” ishte që disa të mbaheshin afër, të tjerët larg”.<sup>11</sup>

Ky qëndrim dëmtoi rëndë unitetin në Byronë Politike të Komitetit Qendror dhe shtoi rreziqet për një luftë fraksioniste joparimore në Byro. Këtë e pranonte si Koçi Xoxe në Raportin e tij për çështjet organizative të Partisë,<sup>12</sup> ashtu dhe S. Malëshova.<sup>13</sup>

Nga diskutimet u bë e qartë se udhëheqja më e lartë e PKSH-së – Byroja Politike ishte përçarë. Pra, në këtë kontekst, ishte realizuar me sukses skenari i PKJ-së.

Miladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha ushtruan një ndikim të madh në zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Provizor, më pas të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike. Të gjitha kuadrot e larta u zgjodhën sipas simpatisë që kishte ai dhe kjo u theksua në Plenum nga të gjithë diskutantët. Vetë Enver Hoxha pohonte se kur u shtrua çështja e zgjedhjes së tij si sekretar politik, “Aliu s’kishte besim te asnjë njeri përveç meje. Di që “Aliu” e mbrojti tezën që unë të isha Sekretar Politik. Kjo gjë më ra si nga qielli, prandaj u thashë që nuk e bëja dot. Pa

<sup>9</sup> . Po aty.

<sup>10</sup> . AQSH, Fondi 14, viti 1944, D. 2/1. *Diskutimi i P.Kristos në Plenumin e Beratit.*

<sup>11</sup> . AQSH, Fondi 14, viti 1944, D. 2/1, fl.8. *Procesverbali i diskutimeve në Plenumin e Beratit.*

<sup>12</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D. 2. *Referati i mbajtur nga K.Xoxe në Plenumin e Beratit.*

<sup>13</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D.2/1, fl.9. *Procesverbali i diskutimeve në Plenumin e Beratit.*

realizuar mirë funksionin e Sekretarit Politik unë pashë në vija të përgjithshme se kjo qe një gjë e madhe për mua, pse unë e njihja veten. Kjo më ka rënduar në veten time, jo vetëm atëherë por edhe më vonë, deri me tani”.<sup>14</sup> Këtu, veç të tjerave, vërehet edhe një kompleks inferioriteti i cili do të ketë përbërë një faktor të rëndësishëm për nënshtrimin servil të Enver Hoxhës ndaj Miladin Popoviqit dhe emisarëve të tjerë jugosllavë, por edhe për akumulimin e pakënaqësive ndaj elementëve të tjerë të udhëheqjes, si: Sejfulla Malëshova, Naku Spiru etj., që konsideroheshin më të aftë se ai. Ky akumulim do të shpërthente shumë shpejt vetëm një vit më vonë. Miladin Popoviqi i kishte bërë kakulimet shumë saktë për interesat e PKJ-së kur kishte propozuar dhe kishte zgjedhur Enver Hoxhën si figurën numër një të PKSH-së. Ishte pikërisht ai që kishte organizuar më pas ngritjen e personit të Enver Hoxhës në Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe të PKSH-së. Enver Hoxha pohonte: “Unë e shihja popullarizimin se ishte artificial”.<sup>15</sup>

Ndaj kuadrove Miladin Popoviqi mbajti një qëndrim të skajshëm mospërfillës. “Ata herë ngriheshin, herë përplaseshin për tokë, pse një fakt i izoluar na vinte në vesh me anë të një raporti që shumë herë nuk ishte shumë serioz dhe i studiuar mirë”.<sup>16</sup> Miladini e mbajti fort në duart e veta monopolin e kuadrove deri në fund të qëndrimit të tij në Shqipëri.

Një gjë tipike është përjashtimi i Ymer Dishnicës nga Komiteti Qendror pa u mbledhur dhe bile pa u lajmëruar fare anëtarët e Plenumit. Këtë çështje e ngriti në Plenum P. Kristo.<sup>17</sup>

Me mjeshtëri Miladini dhe Dushani, duke patur dhe përkrahjen e Enver Hoxhës e Liri Gegës, minuan strukturat organizative të PKSH-së e të Luftës, i injoruan ato duke i kthyer në organizma formalë. Në këtë mënyrë Miladini arriti të vendoste pushtetin e vet personal mbi PKSH-në, Frontin Nacionalçlirimtar dhe Ushtrinë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

Në radhë të parë u asfiksua Komiteti Qendror i PKSH-së. Vetë Enver Hoxha në diskutimet pohon se as zgjedhja e as mbledhjet e këtij forumi më të lartë të Partisë nuk ishin bërë të rregullta.<sup>18</sup> Madje, ai

<sup>14</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D.2/1. *Diskutimi i Enver Hoxhës në Plenumin e Beratit.*

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D.2/1. *Diskutim i P. Kristos në Plenumin e Beratit.*

<sup>18</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D.2/1, fl. 1. *Procesverbal i diskutimeve të Plenumit të Beratit.*

shkonte më tej kur pohonte në mënyrë kategorike: “Komiteti Qendror ishte identifikuar me Miladinin dhe praktikisht Komitet Qendror nuk kish. Komiteti Qendror i joni nuk ka funksionuar si Komitet Qendror edhe ca më pak Byroja e Komitetit. Si Komiteti Qendror ashtu edhe Byroja nuk ishin mbledhur kurrë në rregull për me shtrure problemet në gjerësi dhe në thellësi dhe për me i rrahë çështjet me seriozitetin e duhur”.<sup>19</sup> Inekzistencën e Komitetit Qendror e pohonte dhe Naku Spiru,<sup>20</sup> i cili theksonte: “Komiteti Qendror” nuk mblidhej se (Aliu) nuk donte të diskutoheshin këto gjëra (është fjala për diskutimin e qëndrimit që duhej mbajtur ndaj Ballit Kombëtar). Të njëjtën gjë e pohonte dhe Naxhie Dume, e cila theksonte: “Miladini jo vetëm ka dashur të qëndrojë mbi Komitetin Qendror, por ka patur edhe një rreth të tij shokësh”.<sup>21</sup>

Po kaq e rëndë paraqitej edhe gjendja në Byronë Politike, e cila duke qenë në krye të Komitetit Qendror duhej të bënte një punë kolegjiale. “Byroja Politike edhe kur arrinte të mblidheshin 2-3 shokë, merre vendime të shpejta e të pastuduara mirë”.<sup>22</sup>

Miladin Popoviqi, Dushan Mugosha, Enver Hoxha e Liri Gega, d.m.th. “klika” që dominonte Byronë Politike, e shkelën parimin kryesor të funksionimit të një partie komuniste – centralizmin. Sejfulla Malëshova nënvizonte: “Në Partinë tonë nuk zbatohet principi kryesor i Bolshevizmit, Centralizmi demokratik, por kemi mënjanë “Aliun” dhe dy – tre veta të shkëputur nga Komiteti Qendror e nga Byroja, kemi dhe organizata pa lidhje”.<sup>23</sup>

Miladin Popoviqi e tejkaloj shumë rolin e tij si këshilltar dhe ndihmës i udhëheqjes së PKSH-së dhe, siç pohonte Enver Hoxha në raportin e tij, dhe Sejfulla Malëshova “ai kaloi kompetencat e tij dhe u bë udhëheqës i PKSH-së”.<sup>24</sup> Të njëjtën gjë pohonte dhe Liri Gega, e cila pranonte se: “PKSH-në e ka udhëhequr Aliu, kurse dora e djathtë ka qenë Enveri”.<sup>25</sup>

Roli kryesor i emisarëve jugosllavë ishte bartja e eksperiencës së PKJ-së për drejtimin e luftës. Ky ishte dhe motivi që legalizonte në

<sup>19</sup> Po aty, f.4.

<sup>20</sup> Po aty, f.6.

<sup>21</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D.2, fl.18,19. *Raporti i Enver Hoxhës në Plenumin e Beratit.*

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D.2/1. *Procesverbali i diskutimeve në Plenumin e Beratit.*

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Po aty.

opinionin publik misionin e tyre. Mirëpo, nga Plenumi doli se ata s'bënë asgjë për të transferuar eksperiencën e PKJ-së, për të formuar e lartësuar në aspektin organizativ e politik kuadrot udhëheqëse të PKSH-së. Sejfulla Malëshova theksonte se tendenca e tyre “nuk ka qenë të jepnin eksperiencën e PKJ-së, përkundrazi tendenca e tyre ishte që të mbysnin këtë eksperiencë dhe të mos lejohej që të ngrihej një Komitet Qendror i fortë dhe i aftë në udhëheqje”.<sup>26</sup>

Efektet negative të dominimit të PKSH-së nga emisarët jugosllavë janë në të gjitha planet. Disa u analizuan më lart. Por rezultati më therës ishte se ata u bënë katalizatorë të luftës vëllavrasëse. Shembulli më eklatant për këtë konkludim është prishja e Marrëveshjes së Mukjes, takimi më i rëndësishëm që ndodhi në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku u varros e ardhmja pluraliste e Shqipërisë.<sup>27</sup>

Lidhur më këtë flet fakti se më 11 korrik 1943 (21 ditë para Konferencës në Mukje), Miladin Popoviq i dërgoi letër nga Tirana Pavle Joviqeviqit (i cili pas vrasjes së Boris Vukmiroviqit më 10 prill 1943, ishte emëruar sekretar i Komitetit Krahinor) dhe informoi për situatën e përgjithshme në Shqipëri. Në mes të tjerave Miladini shkruan: “Bisedimet me Ballin Kombëtar nuk po tregojnë sukses, mandej vazhdon, ne kemi për qëllim në fillim Ballin ta copëtojmë në grupe e mandej ta shkatërrojmë deri në fund”.<sup>28</sup> Kjo letër dha shkas që anëtarët e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Metohi të organizojnë një fushatë të gjerë në të gjitha qendrat e Kosovës kundër ithtarëve dhe simpatizantëve të Ballit Kombëtar.<sup>29</sup>

Mbledhja e Mukjes<sup>30</sup>, një ngjarje e cila hyri nëpër dyer të mëdha të historisë shqiptare për Luftën e Dytë Botërore, përbën çelësin për të shpjeguar shkencërisht rolin dominues të Miladin Popoviqit dhe të Dushan Mugoshës mbi PKSH-në, qëndrimin e PKSH-së ndaj nacionalizmës shqiptare progresive dhe rrjedhën e ngjarjeve në këtë kontekst, në vazhdimësi të Luftës Antifashiste.

<sup>26</sup> Aqsh, Fondi 14, viti 1944, D 2. *Procesverbali i Plenumit të Beratit*.

<sup>27</sup> Klement Shalari, (Mos) Marrëveshja e Mukjes kullon ende gjak, Tiranë, 1966, 3-5.

<sup>28</sup> *Zbornik Dokumentata i Podataka o Narodnooslobodilackom ratu Jugoslovenskih Naroda*, (Vojnoistorijski Institut), Beograd 1969, tom 1, knj.19, dok.42. 229.

<sup>29</sup> Dr. Daut Bislimi, *Formacionet Politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 1997, 87.

<sup>30</sup> Dr. Daut Bislimi, vep. e cit. 85-87; Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria në Luftë (1939-1944)*, (Studime dhe refleksione), Tiranë, 2001, 210-214.

Duke iu referuar Mukjes dhe ngjarjeve rreth saj dhe pas saj, disa historianë, edhe tashti<sup>31</sup>, të verbuar nga ideologjia komuniste, e denoncojnë këtë marrëveshje që u arrit në Mukje më 1-2 gusht 1943, duke theksuar se ka qenë fitore e madhe për fatet e Shqipërisë në Luftën antifashiste. Një vlerësim i tillë i papërgjegjshëm, bie në kundërshtim me dëshmitë dokumentare, të cilat vërtetojnë të kundërtën se denoncimi i kësaj marrëveshjeje ishte një fatkeqësi për popullin shqiptar dhe imponoi në mënyrë të dhunshme fillimin e luftës së klasave dhe vëllavrasjen, krahas luftës kundër okupatorit.

Këto dokumente vërtetojnë se prishja e marrëveshjes ishte pjellë e Enver Hoxhës, sepse kështu dëshironin misionarët e PKJ-së Miladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha. KQ i PKJ-së nuk mund ta pranonte një Shqipëri të fortë, një Shqipëri Etnike. Atij i duhej një Shqipëri e tillë që ta përdorte si marionetë për qëllimet e veta politike, deri në përfshirjen e saj në kuadrin e shtetit jugosllav. Prandaj, zgjeroi dhe ushqeu fushatën e përçarjes në të gjitha trojet e Shqipërisë Etnike.<sup>32</sup>

Enver Hoxha, jo vetëm e sulmoi Mukjen dhe e quajti atë tradhti kombëtare, por, nisi kalvarin e gjatë të eliminimit të oficerëve të vjetër e të rinj. Te dënimi i Mukjes i ka rrënjët persekutimi i korpusit të oficerëve shqiptarë dhe të nacionalizmës shqiptare. Aty ai nis me ish-anëtarin e Shtabit të Përgjithshëm, Mustafa Gjinishi, e vazhdon me skenarin e vrasjeve të personaliteteve të Mukjes e të Luftës Çlirimtare Antifashiste.<sup>33</sup>

Menjëherë pas Mukjes, Enver Hoxha (me urdhrin e Miladin Popoviqit dhe të Dushan Mugoshës), thirri mbledhjen në Vithkuq, e cila ishte një gjyq, ku ftoi drejtuesit kryesorë të ushtrisë dhe partisë lidhur më të ashtuquajturin kompromis që kishin bërë në Mukje anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Mbledhjen e hapi Dushan Mugosha i cili me përbuzje sulmoi forcat nacionaliste shqiptare dhe vendimet e Mbledhjes së Mukjes. Enver Hoxha pas shumë diskutimeve dhe polemikave me të tjerët, u dakordua me Dushan Mugoshën dhe Miladin

<sup>31</sup> Dr. Xhemil Frashëri, *“Lufta antifashiste dhe problemi i bashkimit të shqiptarëve banorë në trojet e tyre në një shtet të vetëm shqiptar”* (Kumtesë e lexuar në tribunën politike “Bashkimi Kombëtar e vetmja zgjidhje e drejtë e çështjes shqiptare), Prishtinë, 7-8 qershor 2002.

<sup>32</sup> Dr. Daut Bislimi, vep. e cit., 87.

<sup>33</sup> Prof. dr. Elmas Leci, *Eliminimi i Lidershit Ushtarak Shqiptar (1944-1990) (1992-2001)*, Tiranë, 2002, 75.

Popoviqin që Mustafa Gjinishi dhe Ymer Dishnica, përfaqësues të KNÇ-së, të dënoheshin me vdekje – pushkatim.<sup>34</sup>

Së pari, me angazhimin e saj në Konferencën II të Labinotit, më 4 shtator 1943, Mukja u denoncua zyrtarisht, me tezën se pushteti i Këshillave të LNÇ-së është i vetmi pushtet i popullit. Labinoti tregonte se komunistët luftonin për pushtet.<sup>35</sup>

Miladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha qoftë me qëndrimin e tyre të ndërgjegjshëm, qoftë thjesht me prezencën e tyre si dy figurat kryesore të Lëvizjes Nacional Çlirimtare dhe të PKSH-së, dëmtuan dhe minuan çdo mundësi, çdo përpjekje të asaj pjese të komunistëve shqiptarë për t'u bashkuar me të gjithë nacionalistët progresivë. Këtë fakt e vunë në dukje shumë diskutantë në Plenum, ku përveç të tjerash u hedh poshtë çdo pretendim se Plenumi që i manipuluar nga jugosllavët. Nako Spiru theksonte se emisarët jugosllavë nxitën qëndrimin e ashpër ndaj Ballit Kombëtar. “Tempoja kishte pikëpamjen se vija e jonë ishte oportuniste ndaj Ballit, kurse Balli Kombëtar ishte Drazha Mihajloviqi”.<sup>36</sup>

Akoma më kategorik ishte diskutimi i Sejfulla Malëshovës, i cili pohonte hapur se prania e jugosllavëve në krye të PKSH-së e të luftës dhe veprimet e tyre pa takt, arbitrare dhe ekstremiste i acaruan më tej marrëdhëniet e PKSH-së me nacionalistët. “Dushani në Vlorë e në Gjirokastër kishte krijuar një Republikë me vete... Në Vlorë Dushani shkante vetë e bisedonte me nacionalistët. Ç’mund të thonin ata për këtë? Thonin se këtu është Partia Jugosllave që merret me të gjitha këto gjëra, është ajo që drejton. Elementët jashtë partisë shihnin kështu se PK që konfonduar me Frontin dhe Fronti me Jugosllavinë. Rezultatet kanë qenë shumë të këqija për Frontin”.<sup>37</sup> Ndonëse me vonesë, por Malëshova i kishte vënë pikat mbi. Dushani sabotoi kudo me prirjet e tij të theksuara sektare e terroriste, por veçanërisht në sektorin më të rëndësishëm – Në krahinën e Vlorës, ku shanset qenë më të mëdha për afrimin me nacionalistët, dhe rëndësia e kësaj krahine për lëvizjen ishte e

<sup>34</sup> Xhelal Staravecka, “Bashkimi i Kombit”, dt.31 gusht 1944.

<sup>35</sup> Arkivi i PPSH, fondi 40, dos.12. “Parulla Shqipëria etnike është një parullë fashiste, një parullë raciste”. (Diskutimi i Sejfulla Malëshovës në Konferencën II Nacionalçlirimtare, 4 shtator 1943).

<sup>36</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1942, D.5.

<sup>37</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D. 2/1. *Diskutimet e Sejfulla Malëshovës në Plenumin e Beratit.*

jashtëzakonshme. Pra, ai goditi në pikën më neuralgjike. Rolin negativ të Dushanit në Vlorë e pohonte edhe Hysni Kapo.<sup>38</sup>

Efektet negative të pranisë së emisarëve jugosllavë në krye të PKSH-së dhe të Luftës Antifashiste dëshmohen edhe në burime të tjera. Kështu, p.sh., Koço Tashko në letrën dërguar Internacionales III theksonte se Miladin Popoviçi ka ndikuar fuqimisht në lidhjet e dobëta të PKSH-së me nacionalistët, duke i shndërruar pikëpamjet e tij në vijë zyrtare të PKSH-së. Ai vinte në dukje tezën e Miladin Popoviçit se “nuk duhej bashkuar me nacionalistët, sepse nesër do të ishte i pashmangshëm ballafaqimi me ta”.<sup>39</sup>

Dëme të konsiderueshme sollën dhe pikëpamjet e Miladin Popoviçit për qëndrimin ndaj Ushtrisë shqiptare. Në Plenum kjo çështje u prek tërthorazi, por duke iu referuar letrës së lartpërmendur të Koço Tashkos del në pah se Miladini “ka ushqyer dhe komanduar qëndrimin e PKSH-së ndaj Ushtrisë shqiptare, duke theksuar në këtë kohë të goditej pa mëshirë, njëlloj si okupatori”.<sup>40</sup> Kështu, ai ia mbylli çdo hapësirë punës së Partisë Komuniste për të bërë diferencimin në Ushtrinë shqiptare me anë të propagandës.

Duke siguruar kontrollin mbi PKSH-në, PKJ-ja synonte të zgjidhte në favor të saj çështjen e Kosovës. Në Plenum ky rol negativ i emisarëve jugosllavë nuk u evidencua, por është e padiskutueshme se duke qenë në krye të PKSH-së ata ushtruan rol vendimtar në përcaktimin e vijës së saj kundrejt Kosovës. Kjo vërtetohet nga shumë dokumente të tjera të periudhës së luftës. Në letrën që Koço Tashko ia drejtonte Kominternit, pohonte se Popoviçi ka diktuar vijën e PKSH-së lidhur me Kosovën; ka nxitur qëllimisht mosaktivitetin e popullit kosovar në luftën kundër fashizmit; detyroi PKSH-në të pranonte deklaratën se çështja e Kosovës s’na përket neve, por i përket PKJ-së dhe të heshte për këtë çështje çka i dha dorë fashizmit të luftonte Lëvizjen Antifashiste në Kosovë.<sup>41</sup>

Një problem që vështirë mund të shpjegohet është edhe qëndrimi i emisarëve jugosllavë ndaj njëri-tjetrit. Më saktë mosmarrëveshjet ndërmjet Miladin Popoviçit dhe të tjerëve. Nga diskutimet doli se Miladin Popoviçi kishte shfaqur pakënaqësi ndaj Svetozar Vukmanoviçi – Tempos dhe se ishte munduar ta izolonte atë prej udhëheqësve të

<sup>38</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D. 2/1. *Diskutimi i Hysni Kapos në Plenumin e Beratit.*

<sup>39</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1942, D.5.

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1942, Dos. 5.

PKSH-së. Me ardhjen e Velimir Stojniqit, autoriteti i Miladin Popoviqit pëson një goditje të madhe. Stojniqi ua komunikoi udhëheqësve të PKSH-së se “qëndrimet e Aliut nuk shiheshin me sy të mirë, nuk konsideroheshin të drejta nga PKJ”.<sup>42</sup> Miladin Popoviqi reagoi duke iu kërkuar krerëve të PKSH-së që të mos qëndronin shumë afër Stojniqit, pra të mbanin distancë ndaj tij, duke e ngritur teorinë e independencës. Edhe në Plenumin e Beratit, kur shumë faje po u ngarkoheshin Miladin Popoviqit dhe Dushan Mugoshës, Velimir Stojniqi nuk reagoi, por vazhdoi ta mbulonte me mister çështjen e largimit të M. Popoviqit dhe Dushan Mugoshës. Ai deklaroi: “Unë s’isha i detyruar të tregoja pse u bënë ndryshimi i Miladinit. Por unë e kam thënë atë kohë me qëllim që t’ju bëjë të keni mendjen që Partia të fillojë një rrugë të re. Dhe thashë se Miladini është tërhequr se ka punuar në një mënyrë krejt sektare dhe që këtu masandej del në shesh çështja e Miladinit që sot shokët e kanë paraqitur gjerë e gjatë”.<sup>43</sup>

Interesant është fakti se Velimir Stojniqi porosi kategorikisht Plenumin që të mos dilnin jashtë Komitetit Qendror kritikën që u bënë aty lidhur me Miladin Popoviqin, Dushan Mugoshën dhe Blazho Jovanoviqin, pasi kështu do të vëhej në pikëpyetje karakteri i ndihmës që kishte dhënë PKJ-ja. “Sikurse emrat tuaj nuk mund dalin jashtë në organizatë ashtu edhe emrat e Miladinit, Dushanit dhe Blazhos nuk do të dalin qoftë dhe në shokët më të afërt tuaj. Këtë duhet ta kuptoni dhe këtu duhet të qëndroni të fortë, sepse po të shkonte emri i Miladinit dhe i Dushanit do të kuptohej në mënyrë të shtrembër ndihma e Partisë jugosllave. Edhe në një organizatë të mirë do të kuptohej keq dhe jo në një organizatë të re si kjo e juaja”.<sup>44</sup>

Nga dokumentet e Plenumit, ku bëhej fjalë për ndikimin e emisarëve jugosllavë në PKSH, del se ndaj luftës së aleatëve anglo-amerikanë u mbajt një qëndrim mosbesimi. Gego Nushi theksonte në Plenum: “Ne i ruanim me xhandarë përfaqësuesit e aleatëve”. Ndërkohë vazhdohej të propagandohej gjysmëzyrtarisht lufta e BS-së dhe miqësia me të, ndonëse në Shqipëri po kontribuonin vetëm aleatët anglo-amerikanë.

<sup>42</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, Dos.2/1. *Diskutimi i Nako Spirut në Plenumin e Beratit*

<sup>43</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, D. 2/1. *Diskutimi i Velimir Stojniqit në Plenumin e Beratit*.

<sup>44</sup> Po aty; Dr. Muharrem Dezhgiu – Dr. Beqir Meta, stu. i cit. 59.

Qëndrimin ndaj aleatëve më qartë e pasqyronte Enver Hoxha, i cili pohonte se vija ndaj aleatëve ishte “e lëkundëshme, por më tepër sektare, me qëllim që sa më shpejt t’i mbytnin ata”.<sup>45</sup> Duke folur për qëndrimin intrasigjent e armiqësor ndaj misionëve aleate, Enver Hoxha pohonte: “Menjëherë sa na vinte diçka, edhe për një gjë të vogël ne revolttoheshim dhe merrnim vendim t’i nisnim nga Shqipëria. Bile njëherë morëm një vendim sektar të atillë, që ishte vendimi i Aliut, por që e mbrojta dhe unë, për të kapur Maklinin, për ta burgosur e për ta nxjerrë përpara gjyqit ushtarak. Kur kjo nuk na doli, atëherë Miladini u tërhoq dhe tha sikur vendimin e kishte marrë vetë Enveri”.<sup>46</sup>

Daut BISLIMI

## THE YUGOSLAV EMISSARIES – TUTORS OF THE CPA

### *S u m m a r*

The World War II is a distinguished moment in the Albanian-Yugoslav relations. The particular element is the decision-making influence of the CPY (leader of the Antifascist Liberation War) during the war and in its aftermath.

The influence of the CPY over the CPA and the misunderstanding of this phenomenon for what regards the expansionist aims of the CPY toward the Albanian territories in general, in a time when the Albanian people was oriented toward a war for national liberation and unification, has prompted many scientific discussions in the Albanian historiography.

The ten recent years’ historical researches, which are based in the historical factography, conflict with the attitudes of ideological historiography of the ‘real socialism’ period and argue persuasively that the influence of the Yugoslav CPY emissaries over the CPA was extraordinary and crucial. The activity of the Yugoslav representatives Miladin Popovic and Dusan Mugosa influenced the course of the historical process of the Antifascist Liberation War.

In the materials of Berat’s Plenum (23-27.11.1944) there are important facts for the Albanian history of the World War II on the dependency and total submission of CPA to the CPY, for the perfidious killings of Albanian nationalist and pro-western intelligentsia representatives who were treated like

<sup>45</sup> AQSH, Fondi 14, viti 1944, dos.2/1. *Diskutimi i Enver Hoxhës në Plenumin e Beratit*.

<sup>46</sup> Po aty; Dr. Beqir Meta – Dr. Muharrem Dezhgiu, stud. i cit. 74.

'enemies' and 'nationalist' to be eliminated in order to achieve the common aims and interests of both the CPA and CPY. By means of these facts the true face of the main leaders of Yugoslav emissaries is shown – especially Miladin Popovic, Dusan Mugosa, Velimir Stojanovic and some minor ones – who introduced the terrorist spirit in the CPA, the leader of the Antifascist Liberation War.

The Berat's Plenum was held in the eve of Albania's liberation and was characterised by CPA's propaganda that the Kosova issue was to be resolved after the victory; it was hoped that this issue was to be widely discussed in this Plenum, but this did not happen. This shows that the CPA was not seriously engaged for the resolution of the national issue. This was what the Yugoslav emissaries – active participants of the Plenum - of the CPY wanted.